

Formular për syllabus të lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FAKULTETI I ARTEVE
Titulli i lëndës:	Dizajn Eksperimental
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	OBLIGATIVE
Viti i studimeve:	VITI 3 - SEMESTRI V DHE VI
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Arteve - Dekanati
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ast. Taulant Qerkini
Detajet kontaktuese:	taulant.qerkini@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda “Dizajn Eksperimental” eksploron procesin krijues përmes kërkimit vizual dhe eksperimentimit grafik. Studentët udhëhiqen për të zhvilluar aftësi në identifikimin, analizimin dhe shndërrimin e elementeve vizuale nga përditshmëria në kompozime grafike me vlerë estetike dhe konceptuale.</p> <p>Procesi bazohet në autonominë krijuese të studentit, ku mentori shërben si udhëheqës, ndërsa studenti si vendimmarrës artistik.</p> <p>Në semestrin e parë fokusi është në eksplorimin dhe gjenerimin e formave vizuale përmes eksperimentimit, ndërsa në semestrin e dytë — në strukturimin dhe aplikimin e parimeve estetike të dizajnit grafik në një projekt të integruar.</p>
Qëllimet e lëndës	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të zhvillojë tek studentët ndjeshmëri vizuale, aftësi kërkimore dhe qasje eksperimentale ndaj dizajnit grafik, duke e parë procesin si një mënyrë të të menduarit dhe jo vetëm si prodhim estetik. 2. Studentët mësojnë të kërkojnë, të gjejnë dhe të krijojnë formë përmes konceptit, strukturës, materialit dhe ideve të tyre.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Në përfundim të lëndës, studenti pritët të jetë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aplikoje metoda eksperimentale në zhvillimin e koncepteve vizuale. 2. Krijojë grafika origjinale të bazuara në hulumtim dhe vëzhgim. 3. Strukturë procesin krijues nga ideja deri në kompozimin final. 4. Zbatojë parimet e dizajnit (balanca, kontrasti, ritmi, ngjyra, hierarkia).

	<p>5. Reflektojë mbi punën e tij përmes dokumentimit vizual dhe analizës estetike.</p> <p>6. Prezantojë profesionalisht një projekt të integruar në format digjital dhe fizik.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë	Gjithsej
Ligjërata	2	1	60
Ushtrime teorike	N/A	-	-
Ushtrime praktike	1	1	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.5	-	10
Ushtrime në terren	N/A	-	-
Kollokfiume, seminare	-	2	4 orë (2x2 orë)
Detyra të shtëpisë	0.75 orë	-	22.5 orë
Koha e studimit vetanak të studentit	1.5 orë	-	45 orë
Përgatitja përfundimtare për provim	-	-	10 orë
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	-	-	4 orë
Projektet, prezantimet, etj	-	-	20 orë
Totali	205 orë		
<p>Shpjegim i shkurtër i përlogaritjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● 3 orë mësim në javë × 30 javë = 90 orë (60 ligjërata + 30 ushtrime praktike) ● Pjesa tjetër është shpërndarë sipas standardeve akademike për përgatitje vetjake dhe vlerësim. ● Kjo është e përputhshme me një kurs që ka 6 ECTS, pasi 1 ECTS = ~25–30 orë ngarkesë pune. 			
Metodologjia e mësimdhënies:	<ul style="list-style-type: none"> ● Punëtori praktike në studio ● Kërkim individual dhe në grup ● Prezantime dhe diskutime në klasë ● Vizita studimore në terren ● Konsultime javore me mentorin ● Pjesëmarrje të artistëve dhe dizajnerëve të ftuar nga industria <p><i>Të gjitha detyrat janë praktike dhe zhvillohen nën mbikëqyrjen e mentorit në klasë.</i></p>		

<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<ul style="list-style-type: none"> ● Mësim i bazuar në praktikë Studentët mësojnë duke bërë – përmes vizatimit, modelimit, prerjeve, kolazhit dhe dizajnit digjital. Çdo koncept teorik përcillet me ushtrime praktike dhe mini-projekte. ● Mësim i bazuar në problem dhe projekt Çdo temë semestrale përfshin detyra të ndërtuara rreth një problemi vizual që kërkon zgjidhje kreative. Studentët kalojnë nëpër fazat: hulumtim, ideim, skicim, zhvillim, testim dhe prezantim. ● Kritika dhe reflektimi Diskutimet kolektive dhe prezantimet e punëve shërbejnë si mjet për zhvillimin e gjykimit estetik dhe të aftësisë për të komunikuar konceptin vizual. Kritika trajtohet si proces bashkëpunues, jo konkurrues, duke nxitur vlerësimin konstruktiv dhe vetë-reflektimin. ● Integrimi i teknologjisë Përdorimi i programeve profesionale si Adobe Illustrator, Photoshop, Figma etj. aplikohet në fazat e avancuara të projektit, duke balancuar punën manuale me atë digjitale. ● Eksperimentimi i lirë Studentët inkurajohen të eksperimentojnë me materiale, ngjyra, tekstura dhe forma që i marrin nga përditshmëria e tyre, për të zhvilluar një gjuhë autentike grafike dhe stil personal. ● Ndërlidhja teori–praktikë Konceptet teorike të elementeve të dizajnit (forma, vijë, ngjyrë, hapësirë, hierarki, kontrast) mësohen përmes shembujve realë nga historia e artit, dizajnit modern dhe grafikës bashkëkohore, dhe më pas aplikohen në punë konkrete. ● Reflektimi dhe vetëvlerësimi Çdo student mban një <i>ditar vizual</i> (sketchbook / design journal), ku dokumenton procesin e punës, zgjedhjet estetike dhe zhvillimin e mendimit vizual gjatë semestrit.
-------------------------------------	--

	<ul style="list-style-type: none"> ● Pjesëmarrja aktive dhe angazhimi në klasë – 20% ● Detyrat e ndërmjetme dhe ushtrimet praktike – 30% ● Projekti final 1 - 25% ● Projekti final 2 - 25%
Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> ● Harris, David – The Art of Calligraphy ● Lupton, Ellen – Thinking with Type ● Catich, Edward – The Origin of the Serif ● Coles, Stephen – The Anatomy of Type
Literatura shtesë:	https://www.biblioteka-ks.org/ https://bibliotekadigitale-ks.org/documents https://www.gutenberg.org https://www.doabooks.org https://www.springer.com/gp/open-access/books
Burimet: https://www.biblioteka-ks.org/burime/	

<i>Java</i>	<i>Tema</i>	Përmbajtja Kryesore	Aktivitetet / Ushtrimet	Detyra / Vlerësimi
1	<i>Hyrje në Dizajnin Eksperimental</i>	Roli i eksperimentit në dizajn; ndikimi i dizajnit grafik në periudha të ndryshme	Diskutim mbi revista si <i>Eye Magazine, Print, Design Observer</i>	Reflektim mbi rolin e eksperimentit në dizajn

2	<i>Zgjedhja e temës individuale</i>	Hulumtim mbi natyrën, objektin ose konceptin personal	Kërkim vizual dhe dokumentim fotografik/skicor	Dorëzimi i konceptit tematik individual
3	<i>Hulumtimi vizual dhe inspirimi</i>	Analizë e formave natyrore dhe strukturore	Ushtrime vizatimi të lirë me medime të ndryshme	Koleksion skicash hulumtuese
4	<i>Eksperimentimi me forma grafike</i>	Deformim, abstraksion, ritëm vizual	Punëtori në studio	Kompozime të para eksperimentale
5	<i>Materiali si mjet shprehës</i>	Eksplorim i materialeve (bojë, tekstil, letër, digjital)	Eksperimentim me sipërfaqe	Vlerësim i progresit në klasë
6	<i>Analizë vizuale e rezultateve</i>	Rishikim i punëve, diskutim kolektiv	Prezantim dhe reflektim	Përmirësim i zgjedhjeve vizuale
7	<i>Struktura dhe ritmi vizual</i>	Ndërtimi i rendit vizual përmes përsëritjes	Ushtrim me pattern-e dhe tekstura	Mini-projekt me strukturë ritmike
8	<i>Kompozimi i elementeve grafike</i>	Raporti mes formës dhe hapësirës	Ushtrime në format të madh	Kompozicion në bardh-hiri-zi
9	<i>Prezantim ndërmjetës</i>	Review me mentorin dhe kolegët	Diskutim mbi procesin	Feedback kolektiv
10	<i>Vizitë nga industria</i>	Ligjëratë nga dizajnerë të ftuar	Sesion Q&A	Reflektim mbi ndikimin praktik
11	<i>Përmirësim i kompozicioneve</i>	Riorganizim i punës në bazë të feedback-ut	Konsultime individuale	Versioni i dytë i punës
12	<i>Eksperimentim digjital</i>	Përdorimi i mjeteve digjitale për transformim vizual	Punë në kompjuter	3 kompozime digjitale
13	<i>Bashkimi i teknikave</i>	Kombinimi i elementeve fizike dhe digjitale	Workshop "Hybrid Media"	Finalizim i punimeve

14	<i>Përgatitja e projektit final</i>	Strukturimi i prezantimit përfundimtar	Simulim prezantimi	Dorëzimi paraprak i projektit
15	<i>Prezantimi final</i>	Ekspozim i punëve eksperimentale	Prezantim publik / kritikë kolektive	Projekt final: Kompozim Bardhë–Hiri–Zi
16	<i>Hyrje në Parimet e Dizajnit</i>	Balanca, kontrasti, hierarkia – roli i tyre estetik	Leksion dhe diskutim	Analizë e shembujve
17	<i>Balanca & Simetria / Asimetria</i>	Struktura vizuale dhe ekuilibri estetik	Ushtrim praktik	2 kompozime eksperimentale
18	<i>Kontrasti & Theksimi</i>	Raporti i dritës dhe errësirës, tonet vizuale	Eksperimentim me tone	Mini-projekt
19	<i>Hierarkia & Proporcioni</i>	Raporti midis elementeve dhe rëndësisë vizuale	Skicim dhe layout	Ushtrime hierarkike
20	<i>Harmonia & Konsistenca</i>	Uniteti në kompozim, balancimi i formës	Workshop kolektiv	Kompozim harmonik
21	<i>Ritmi & Përsëritja</i>	Lëvizja dhe energjia vizuale	Ushtrime me pattern-e	Detyrë ritmike
22	<i>Hapësira e Bardhë & Margjinat</i>	Roli i hapësirës negative në kompozim	Analizë dhe krijim	Poster minimalist
23	<i>Rreshtimi & Gridi</i>	Sistemet strukturore në dizajn	Ushtrime me rreshtim	Layout tipografik
24	<i>Teoria e Ngjyrave</i>	Marrëdhëniet kromatike dhe psikologjia e ngjyrës	Eksperiment me paleta	Kompozime kromatike
25	<i>Prezantim ndërmjetës</i>	Review kolektiv	Feedback mentor + klasë	Reflektim procesi

26	<i>Kombinimi i parimeve</i>	Ndërtim i kompozimeve të integruara	Workshop “Mixed Principles”	Seria e kompozimeve
27	<i>Aplikim digjital</i>	Integrim i dizajnit eksperimental në platforma digjitale	Punë në Adobe / Figma	Eksport në format PDF
28	<i>Përgatitja e projektit final</i>	Përzgjedhje e punimeve për prezantim	Konsultime individuale	Draft final
29	<i>Dokumentimi dhe prezantimi</i>	Formatimi i dosjes PDF për ekspozim	Workshop me mentorin	Dorëzim paraprak
30	<i>Prezantimi final</i>	Ekspozim dhe mbrojtje e projektit final	Prezantim profesional	Projekt Final Integruar (PDF)

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat që do t’u jepen. Studentët inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe të hapin diskutime lidhur me to. Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata. Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studentit duhet t’i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.